

VENDIM
Nr. 149, datë 31.3.2000

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË ZË
REHABILITIMI I AKSIT RRUGOR DURRËS - RROGOZHINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 9, të ligjit nr.7848, datë 25.7.1994, "Për shpronësimin për interes publik si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme", me propozimin e ministrit të Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për sipërfaqen: truall 11026 m2 dhe tokë bujqësore 134 746 m2, që zë rehabilitimi i aksit rrugor "Durrës-Rrogozhinë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e këtyre pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore, që i bashkëlidhen këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 126 659 172 (njëqindnjëzetegjashtë milionë e gjashtëqindpesëdhjetenëntë mijë e njëqindeshtatëdhjetedy) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt në buxhetin e vitit 2000, të Ministrisë së Transportit, në zërin "Shpronësime".

5. Shpronësimi të përfundojë brenda muajit gusht të vitit 2000.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, bashkia e Kavajës, bashkia e Rrogozhinës dhe komunat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta